



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

(Specialist Mjedisi)

Lloji i diplomës “Inxhinieri Mjedisi dhe Pyjesh, Bio-Kimi etj.”  
Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit të Dytë”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetëore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Mallakastër** shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

Specialist Mjedisi, <i>Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit</i> , <b>Kategoria IV- 3</b>	1 (një)
---	---------

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil. Nëse nuk ka një fitues nga procedura e lëvizjes paralele, plotësimi i vendit vakant do të realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimi në Shërbimin Civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

**Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 16.12.2025**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 22.12.2025**

## Përshkrim i Përgjithshëm

### *Specialist Mjedisi, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit, Kategoria IV-3*

1. Specialisti varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
2. Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij.
3. Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, sipas fushave që mbulon sektori.
4. Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim, duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara. Përgatit materialin dhe pasi e siglon ia paraqet përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë;
5. Mban përgjegjësi për cilësinë dhe saktësinë profesionale të materialeve të përgatitura.
6. Punon në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetiake tekniko-profesionale dhe marrin pjesë në veprimtaritë trajnuese për këtë qëllim, në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar, por edhe të karrierës në shërbimin civil, të njohë legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë atë që lidhet me punën sipas specifikës së fushës që mbulon.
7. Zbaton dhe përgjigjet për detyra të tjera të ngarkuara nga përgjegjësi i sektorit.
8. Te zbatoj orarin zyrtar, disiplinën dhe etikën profesionale në punë.

## DETYRAT

### Detyrat Kryesore

*Specialist Mjedisi*, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit, **Kategoria IV-3**

Është punonjes ne varesi direkte te Pergjegjesit te Sektorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

1. Punon per parandalimin, kontrollin dhe uljen e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji.
2. Punon per ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike.
3. Kontrollon përdorimin e matur dhe racional te natyrës dhe burimeve të saj.
4. Punon per ruajtjen dhe rehabilitimin e vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror.
5. Punon per mbrojtjen dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit.
6. Kujdeset per mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.
7. Bën nxitjen e informimit, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
8. Në fillim të çdo viti, raporton në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës
9. Jep pergjigje ligjore dhe teknike per problemet specifike qe mbulon sipas detyrave qe i ngarkohen
10. Bashkpunon me Inspektoriatin e Policise Bashkiake.
11. Zbaton dhe pergjigjet per detyra te tjera te ngarkuara nga drejtori dhe pergjegjesi i sektorit.
12. Te raportoj ne menyre periodike mbi zbatimin e detyrave te ngarkuara.
13. Te zbatoj orarin zyrtar ,disiplinen dhe etiken profesionale ne pune.

## I. LEVIZJA PARALELE

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

**1.1. Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë".

Kriteret e vecanta për këtë pozicion janë:

- a. Të zotërojë Diplomë të Nivelit të Dytë, "Master Profesional/Shkencor", në Inxhinieri Mjedisi dhe Pyjesh, Bio-Kimi etj. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi,
- b. Të ketë të paktën 1 vit punë,
- c. Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

## 1.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë **me postë në një zarf** të mbyllur, në **zyrën e Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër**, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit.
4. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
5. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
6. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
7. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
8. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
9. Vërtetim të gjendjes gjyqësore dhe shëndetsore. (Dëshmi penaliteti dhe raport mjekesor).

**Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë 16.12.2025.**

## 1.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **17.12.2025** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën e kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së

verifikimit paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes e-mailit të paraqitur nga kandidati në dokumentacionin e aplikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj.

#### **1.4.FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

**Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 “Per vetqeverisjen Vendore”.
- Kodi I Precedurës administrative.
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligj Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”.
- Ligj nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

#### **1.5.MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:**

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Mallakastër**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

1. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve me pune , në rastet kur procesi I certifikimit nuk është kryer;
2. **60 pikë** për intervistën me gojë;

#### **1.6.DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Mallakastër**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve me pune , në rastet kur procesi I certifikimit nuk është kryer;  
**60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

## **2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL.**

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

### **2.1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të detyrës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar (hequr) sipas këtij ligji.

#### **Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:**

Të zotërojë Diplomë të Nivelit të Dytë ‘‘Master Profesional/Shkencor’’, në degët Inxhinieri Mjedisë dhe Pyjesh, Bio-Kimi etj Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

### **2.2.DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:**

Kandidati duhet të dërgojë me **postë në një zarf të mbyllur, në zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Mallakastër** këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit.
3. Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
4. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
5. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
6. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
7. Fotokopje e letërnjoftimit.
8. Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetësore.

**Dokumentat e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë 22.12.2025.**

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **24.12.2025** NJBNJ do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në stendën e informimit të publikut, **listën e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit, në rrugë elektronike nëpërmjet emailit. Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerezore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me goje, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore".
- Kodi I Procedurës administrative.
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Ligj Nr. 68/2017 "Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore".
- Ligj nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë të cilat ndahen përkatësisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

**Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "

Specialist Mjedisit, *Spektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit*. **Kategoria IV-3**

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive".

**Komiteti i Përhershëm i Pranimit** brenda 24 (njëzet e katër) orëve, vendos në dispozicion listën e fituesve, Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, shpall listën e fituesve.

**Njoftimi do të bëhet:**

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në stendën e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në :

e-mail : [jllakaj@bashkiamallakaster.gov.al](mailto:jllakaj@bashkiamallakaster.gov.al)

**NJESIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**BASHKIA MALLAKASTËR**

**JONIDA LLAKA**

**MERUSHE QALLIAJ**

**AURORA HEQIMAJ**

